



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 802/1 Prot.

Tiranë, më 02 . 06 . 2025

V E N D I M

Nr. 133, datë 02 . 06 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 117 Regj., datë 21.05.2025, të shtetasit S. V, kundër avokatit B. N, në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Referuar parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, z. S. V, ndër të tjera, citohet se: “Në vitin 2005, Gjykata vendosi të më dënonte padrejtësisht me 12 vite burg, për akuzën e “Vrasjes në rrethana cilësuese ndaj oficerëve të policisë në Shkodër” dhe “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, pavarësisht se, natën kur ndodhi krimi i supozuar, unë nuk isha në dijeni të faktit që burrat që ishin në prag të derës time ishin oficerë të policisë.

Atë natë, nga frika e pranisë së këtyre personave, dola në ballkon dhe me armën personale qëllova në drejtim të qiellit. Në momentin që kuptova se personat në fjalë ishin oficerë të policisë, u vetëdorëzoja.

Gjatë burgimit ka pasur raste kur edhe jam torturuar. Pas daljes nga burgu, në vitin 2014, kam bërë disa ankesa në disa institucione për të vërtetuar pafajësinë time dhe për të marrë ato që më takojnë me ligj.

¹ Pa provuar apo dokumentuar se çfarë pretendon a shpjegon subjekti ankues me këtë shkak.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Për të ndjekur të drejtën time kam marrë një avokat, z. B. N, me të cilin ramë dakord për të kryer pagesën prej 500 000 lekësh për shërbimin e tij, pagesë të cilën e kemi bërë para noterit. Për një vit rresht, pavarësisht premtimit për të hapur çështjen time, ai më ka mbajtur me gënjeshtër. Në një moment më tha që do të më kthente lekët mbrapsht por sërish më ka gënjyer. Kam bërë denoncime në institucione të ndryshme si në Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorinë e Përgjithshme, por ato më kanë nxjerrë justifime të ndryshme. Kërkoj që të vihet përpara përgjegjësisë avokati B. N dhe të bëjmë një pajtim.”

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri: “Konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e dëmshpërblimit për vitet e bëra padrejtësisht në burg.”

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Nga këqyrja e akteve të depozituara pranë KMD-së, rezulton, ndër të tjera se, në shkresën me nr. 3277/1 prot., datë 10.04.2014, të Institucionit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale (IEVP) Lezhë, “Urdhër lirimi për të dënuarin S. P. V”, për ankuesin rezultojnë të dhënat si më poshtë citohen:

- “Me vendimin nr. 207, datë 12.11.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, shtetasi S. V...është deklaruar fajtor dhe dënuar me 12 vite burgim, për veprën penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese kundër dy a më shumë personave mbetur në tentativë dhe armëmbajtje pa leje”, parashikuar në Kodin Penal.
- Arrestuar më datë 29.04.2004
- Gjatë vuajtjes së dënimit, deri më datën 10.04.2014, ka:
 - Vuajtur fizikisht 9 vjet, 11 muaj dhe 11 ditë
 - Fituar me paraburgim 1 vit, 6 muaj dhe 12 ditë
 - Fituar me amnisti nr. 22/2014, datë 10.03.2014, 3 muaj dhe 7 ditë.
 - Vujatur gjithsej 12 vite.
- Sot me datë 10.04.2014 bëhet lirimi i të dënuarit S. P. V nga IEVP Lezhë, me ligj nr. 22/2014, datë 10.03.2014, neni 4 “Për dhënie amnistie...”

Nëpërmjet Kontratës së Porosisë me nr. Rep 40; nr. Kol 27/1, datë 23.01.2018, para noterit A. H, është nënshkruar kontrata e porosisë “Për kryerje shërbimesh profesionale juridike”, ndërmjet palës ankuese, z. S. V dhe Avokatit B. N.

Në nenin 1, të kësaj Kontrate, është përcaktuar dhe objekti i saj, shprehimisht si vijon: “Nëpërmjet kësaj kontrate, palët rregullojnë marrëdhëniet e porosisë dhe shpërblimit për shërbimet e kryera në emër të Porositësit nga i Porosituri, për përfaqësimin ligjor përpara instancave gjyqësore që ka juridiksionin dhe kompetencën brenda territorit të RSH-së, si dhe përpara Gjykatës së Strasburgut, me objekt: “Përfaqësimin juridik dhe mbrojtjen e porositësit në kuadër të kryerjes së procedurave ligjore, për rishikimin e vendimit nr. 1469/599 Regj. Themeltar, nr. 733 Vendimi, datë 01.12.2006, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me qëllim marrjen e pafajësisë për porositësin S. V”. I porosituri ka afat për realizimin e objektivit të mësipërm një periudhë kohore prej një viti nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.”

Në nenin 3 “Mënyra e shpërblimit”, specifikohet se: *“Si shpërblim për kryerjen e porosisë Porositësit marrin përsipër të paguajnë në llogari të të Porositurit pagesën prej 500 000 lekësh, e cila është likuiduar paradhënie sot, ditën e nënshkrimit të kësaj kontrate, jashtë kësaj zyre noteriale dhe palët e konfirmojnë këtë fakt, pa asnjë pretendim”.*

Ankuesi shprehet se, pas kalimit të afatit të përcaktuar në këtë kontratë, pra, një viti nga nënshkrimi i saj, (23.12.2018 – 23.01.2019), do të duhej të kishte marrë shërbimin e rënë dakord paraprakisht sipas kushteve të caktuara në kontratë.

Ndodhur në situatën kur nga Av. B. N, z. V, nuk i është ofruar shërbimi sipas kushteve të dakordësuara, si dhe nuk i është kthyer mbrapsht pagesa e bërë (për shërbimin që do t’i ofrohej dhe nuk u krye) ankuesi pretendon se është mashtruar prej tij.

Për sa më sipër, subjekti ankues kërkon para KMD-së: *“Konstatimin e diskriminimit nga ana e Av. N dhe marrjen e dëmshpërblimit për vitet e kaluara në burg padrejtësisht.”*

Bazuar në analizën e deklarimeve të depozituara nga subjekti ankues, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari, sa i takon pretendimit të subjekti ankues se është diskriminuar *“për çdo shkak tjetër”*.

Subjekti ankues ka shënjuar *“çdo shkak tjetër”* tek lista e shkaqeve në formularin e ankesës të KMD-së, pa shpjeguar e argumentuar atë.

Ankuesi ka pretenduar për trajtim të padrejtë të tij, nga ana e Av. B. N, pa dhënë ndonjë shpjegim apo fakte e prova se ky trajtim bazohet në ndonjë karakteristikë, apo cilësi të veçantë të tij, bazuar mbi të cilën të prezumohej trajtimi i tij i pafavorshëm e i padrejtë.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se, vetëm fakti që një person posedon këto shkaqe të mbrojtura, nuk mjafton për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për shkaqet e pretenduara, por jo vetëm, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi *“çdo shkak tjetër”*. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të padrejtë, vijnë për shkakun e pretenduar, duhet që fillimisht ky shkak të jetë i provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkak i njohur nga LMD.

Sa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1. Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut

³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’*, i ndryshuar citon se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

(KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁴.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”*⁵

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes *“me çdo shkak tjetër”*, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

⁴ Neni 14, I KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

⁵ Shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

Komisioneri vëren se, “viktimat” e diskriminimit e kanë detyrimin të paraqesin fakte dhe prova nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim apo mbi bazën e të cilave të bëjnë të besueshëm pohimin se është bërë diskriminim.

Pastaj, barra e provës i bartet të paditurit, i cili gjatë zhvillimit të procedurës hetimore duhet të dëshmojë se nuk ka pasur diskriminim, apo se ka pasur arsye ligjore për trajtim të pabarabartë. Komisioneri vlerëson se, diskriminimi⁶ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

Pala ankuese nuk provon me fakte e prova se mbart shkaqet e pretenduara, sipas përcaktimeve të LMD-së.

Në kuptim të LMD-së, “*Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.*”⁷”.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Kjo pasi, ankuesi nuk ka arritur të provojë apo dokumentojë se çfarë konsideron me “çdo shkak tjetër”, pra se cila është karakteristika e tij individuale, bazuar mbi të cilën subjektet kundër të cilëve ka paraqitur ankesën, e kanë trajtuar në mënyrë të diferencuar e të padrejtë.

Në mungesë të provave e fakteve mbi të cilat supozohet se ka pasur diskriminim, pamundësohet vijimi i procedurës për shqyrtimin e ankesës.

Vendimmarrja e Komisionerit duhet të jetë e arsyetuar dhe e argumentuar mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

⁶ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

⁷ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Provat janë të dhëna që merren prej burimeve (subjektit ankues në këtë rast) dhe sipas rregullave të përcaktuara në ligj, të cilat vërtetojnë ose rrëzojnë pretendimet e palëve në proces (neni 11, i Kodit të Procedurës Civile).

Subjekti ankues i cili pretendon diskriminimin, ka detyrimin që të provojë me fakte, shpjegime e prova bindëse, nëpërmjet të cilave duhet të krijojë bindjen se mund të prezumohet diskriminimi.

Pala ankuese nuk parashtroi e depozitoi prova, fakte apo rrethana nga të cilat të mund të prezumohet se ka patur sjellje, veprime apo mosveprime të institucionit përgjegjës që të jenë motivuar nga shkak i pretenduar, pasi *vetë shkak* nuk është i provuar prej tij.

Vetëm pasi ankuesi të provonte para KMD-së se mbart e posedon shkakun e pretenduar, atëherë Komisioneri mund të vihej në lëvizje për të kërkuar informacion lidhur me veprimet apo mosveprimet e institucionit përkatës.

Për rrjedhojë, për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) ... nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim⁸”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, e për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj, për shqyrtimin e saj.

Së dyti, sa i takon pretendimit të subjekti ankues, për veprimet e mosveprimet e av. B. N, lidhur me momentin kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, Komisioneri evidenton se;

Ankuesi ka cilësuar tek formulari i ankesës si më poshtë:

“Koha kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar ” - duke shënjuar datën 23.01.2018.

“Koha kur ka marrë dijëni për diskriminimin e pretenduar” - duke shënjuar vitin 2019.

Për rrjedhojë, Komisioneri vëren se, të gjitha pretendimet që burojnë nga veprimet e mosveprimet e avokatit B. N, lidhen pazgjidhshmërisht me periudhën kur ato supozohet se kanë ndodhur (23.01.2018), ose marrë dijëni (vitin 2019) dhe përsa i takon të drejtës së kundërshtimit të tyre, ndiqet e drejta e ankimit brenda afateve të caktuara ligjore.

⁸ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 163, datë 14.08.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 205, datë 19.10.2023, të KMD-së, Vendimin nr. 226, datë 06.11.2023, të KMD-së, Vendimi nr. 27, datë 23.01.2024, etj.

- Subjekti ankues ka pohuar se është vënë në dijeni të veprimeve diskriminuese të pretenduara, nga ana e avokatit B. N, kundrejt personit të tijj, në vitin 2019⁹ dhe se diskriminimi kishte ndodhur në datën 23.01.2018.
- Në kontekst të sa mësipër, subjekti ankues ka marrë dijeni lidhur me faktin për të cilin dhe *pretendon diskriminimin*, që në vitin 2019. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 21.05.2025, pra më vonë se dy vite nga marrja dijeni.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese*”, ankesa e shtetasit S. V, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj¹⁰.

Pra, konkludojmë së janë tejkaluar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Së treti, lidhur me pretendimin e ankuesit për mashtrim nga ana e Av. B. N, Komisioneri vëren se, sipas legjislacionit penal në RSH, “*mashtrimi*” është vepër penale dhe hetimi i tij nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.¹¹ Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: “*Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre*”.

Neni 143, i Kodit Penal, përcakton se: “*Përvetësimi i pasurisë private ose publike nëpërmjet paraqitjes së fakteve të rreme ose duke fshehur fakte të vërteta, gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit, për vete ose persona të tjerë, përbën veprën penale të mashtrimit dhe dënohet me burgim deri në pesë vjet.*

Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dy deri në gjashtë vjet.

Kur vepra ka sjellë pasoja të rënda dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”

⁹ Deklarim i ankuseses, si dhe bazuar në aktet bashkëlidhur ankesës.

¹⁰ Për analogji citojmë vendimin nr. 33, datë 07.02.2022, vendimin nr. 22, datë 19.01.2024, të KMD-së.

¹¹ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: “*Prokuroria ushtron ndjekjen penale...*”

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

Lidhur me këtë kërkim, pra, për pretendimin për mashtrim nga ana e Av. B. N, ankuesi mund t’i drejtohet organit të Prokurorisë.

Së katërti, lidhur me pretendimin e ankuesit për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale nga ana e Av. B. N, sa i takon mosdhënies së shërbimit ligjor të dakordësuar mes tyre, para Noterit, Komisioneri vëren se, ky është një kërkim të cilin ankuesi mund ta kërkojë e ezaurojë gjyqësisht, në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

Neni 698 i Kodit Civil, parashikon se: “Në kontratat me detyrime të ndërsjella, kur njëra nga palët kontraktuese nuk përmbush detyrimet e veta, pala tjetër kontraktuese sipas rastit, mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ose zgjidhjen e kontratës, përveç shpërblimit të dëmit”.

Kuptimi i fajësisë në mospërbushjen e detyrimit kontraktor përcaktohet në nenin 480, të Kodit Civil sipas këtij formulimi: *“Debitori është me faj kur me dashje ose nga pakujdesia, ka krijuar rrethana që e kanë bërë të pamundur ekzekutimin ose kur nuk ka marrë masa për ta ndaluar atë”*.

Interpretimin dhe disponimin lidhur me zbatimin ose jo të këtyre dispozitave, analizuar në raport me faktet e provuara gjatë gjykimit gjyqësor, mund ta japë vetëm organi kompetent, që është Gjykata. Në këto kushte, ankuesi mund ta ndjekë dhe ezaurojë gjyqësisht, kërkimin e tij për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale nga ana e Av. B. N, si dhe për shpërblim të dëmit që i është shkaktuar atij.

Nga gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ky kërkim i ankuesit, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ...”*, ankesa lidhur me këtë kërkim të z. V, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/ç/dh, nenin 33, pika 10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasit S. V, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA